

V E N D I M
Nr.43, datë 29.1.1993

**PËR DHËNIEN E AUTORIZIMIT PËR FLUTURIMIN E AEROPLANËVE
USHTARAKË NË HAPËSIRËN AJRORE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Me propozimin e Ministrisë së Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Autorizohet fluturimi i aeroplanëve ushtarakë të Forcave të Mbrojtjes të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, me komandë rajonale në Zagreb, në hapësirën ajrore të Republikës së Shqipërisë, me pikë hyrje Rodom dhe dalje Mavar.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Transporteve dhe e Komunikacioneve dhe Ministria e Punëve të Jashtme.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi